



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opstina J.Mitrovica – Municipality of S. Mitrovica

Drejtoria e Inspeksionit

REFERENCE:	
PËR/ZA/TO:	Subjektet Afariste dhe Shitësit Ambulant
CC:	Kryetari i Komunës z. Bedri HAMZA
NGA/OD/FROM:	Drejtori i Inspeksionit z. Valon BRAHIMI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	NJOFTIM - Për lirim të hapësirës publike-trotuarit
DATA/DATUM/DATE:	11.02.2025

Të nderuar,

Në zbatim të Rregullores Komunale Nr. 01/2023 për Shfrytëzimin e Përkohshëm të Sipërfaqeve dhe Hapësirave Publike, akteve tjera normative dhe me qëllim të mbajtjes së rendit ligjor-komunal dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për lëvizje të qytetarëve, përmes kësaj shkrese njoftohen subjektet afariste, shitësit ambulant dhe personat fizik se vendosja pa leje e kiosqeve, mallrave për konsum-pemë dhe perime, frigoriferëve karriga dhe tavolina, stenda, dhe objekte tjera, është në kundërshtim me rregulloren në fjalë dhe aktet tjera normative dhe për këtë arsye duhet të largohen nga sipërfaqet publike.

Po ashtu e njëjta vlenë edhe për subjektet të cilat veprojnë në kundërshtim me lejet relevante.

Nëse subjektet përgjegjëse nuk veprojnë sipas njoftimit si më lartë, Drejtoria e Inspeksionit nga data 18.02.2025 e martë, do të ndërmerr të gjitha veprimet konform dispozitave ligjore relevante përfshirë gjopa dhe masa administrative si: sekuestrime dhe konfiskime të paisjeve, objekteve, mallrave - materiale të ekspozuara në sipërfaqe publike, në kundërshtim me dispozitat në fjalë.

Ky njoftim vlenë në veçanti për subjektet të cilat shfrytëzojnë hapësirën publike-trotuarin në rrugën: “Mbretëresha Teutë, “Ali Zenel” dhe “Fatmire Hetemi” .

Me respekt!